



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

Nr. 2858/11 prot. datë 30.04.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË,  
KULTURËS DHE INOVACIONIT

Nr. 5820/2 prot. datë 13.5.2024

### URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 193, datë 30.04. 2024

### PËR

### MIRATIMIN E STRUKTURËS SË VITIT SHKOLLOR 2024 – 2025 NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

### U R D H Ë R O J M Ë:

Struktura e vitit shkollor 2024-2025 të jetë si më poshtë:

1. Në arsimin bazë:
  - a) Mësimet fillojnë më 9 shtator 2024 dhe mbarojnë më 13 qershor 2025.
  - b) Pushimet fillojnë më 23 dhjetor 2024 dhe mbarojnë më 3 janar 2025.
  - c) Pushimet fillojnë më 31 mars 2025 dhe mbarojnë më 4 prill 2025.
  - ç) Provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 16-27 qershor 2025.
2. Në arsimin e mesëm të lartë:
  - a) Mësimet fillojnë më 9 shtator 2024 dhe mbarojnë më 13 qershor 2025.
  - b) Për maturat, mësimet fillojnë më 9 shtator 2024 dhe mbarojnë më 30 maj 2025.
  - c) Pushimet fillojnë më 23 dhjetor 2024 dhe mbarojnë më 3 janar 2025.
  - ç) Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 2-27 qershor 2025.
3. Në arsimin profesional:
  - a) Mësimet fillojnë më 9 shtator 2024.
  - b) Për nxënësit e klasave të 10-ta për të gjitha strukturat, nxënësit e klasave të 12-ta për strukturën, 2+2 si dhe për nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta për strukturën 4-vjeçare, mësimet mbarojnë më 13 qershor 2025.
  - c) Për nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta për strukturën 2+1+1 dhe për nxënësit e klasave të 11-ta për strukturën 2+2, mësimet mbarojnë më 30 maj 2024.

- ç) Për të gjithë nxënësit maturantë, mësimet mbarojnë më 16 maj 2025.
- d) Pushimet fillojnë më 23 dhjetor 2024 dhe mbarojnë më 3 janar 2025.
- dh) Provimet përfundimtare për kualifikimet profesionale të Nivelit II dhe III të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KShK) zhvillohen në periudhën 2-13 qershor 2025.
- e) Provimet përfundimtare të praktikës profesionale të kualifikimeve profesionale të Nivelit IV të KShK-së zhvillohen në periudhën 26-30 maj 2025.
- ë) Provimet e Maturës Shtetërore Profesionale zhvillohen në periudhën 2-27 qershor 2025.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

*Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.*

**MINISTRI I ARSIMIT**

**DHE SPORTIT**

**OGERTA MANASTIRLIU**



**MINISTRI I EKONOMISË,**

**KULTURËS DHE INOVACIONIT**

**BLENDI GONXHJA**

